



M.A.D
magazine

1 multimedia.art.design

SONIA JOJIC
STILL EXHIBITION



Kontakt:

Rr. "Bylis" Nr. 12, Autostrada Tirane - Durres,
Km.5, Kashar.

Kodi Postar 1051, KP 2995, Tirana Albania

Tel: +355.(0)4.24074 - 20/21,

Fax: +355.(0)4.2407422,

Cel: +355.(0)69.20 - 34126 / 81881,

E-mail: forum_ap@universitetipolis.edu.al

Web: www.universitetipolis.edu.al



Instituti Kërkimor Shkencor IKSH_POLIS
Njësia e botimeve POLIS_press

Botues: Besnik Aliaj, Sotir
Dhamo, Dritan Shutina

Drejtor: Besnik Aliaj
Kryeredaktor: Sotir Dhamo

Këshilltarë: Gëzim Qëndro
Elvan Dajko

Këshilli Redaksional: Alket Frashëri (Tiranë)
Agron Mesi (Tiranë)
Eno Barjami (Tiranë)
Romeo Kodra (Tiranë)
Sonia Jojic (USA)
Eranda Janku (Tiranë)
Stefano Romano (Itali)
Simina Turcu (Rumani)

Redaktor Letrar: Kleitia Vaso

Art Design/Layout: Sonia Jojic

Shtypur nga:

MAD magazine – është një botim i “MAD center” një hapësire alternative e ekspozimit, performancave dhe kërkimit mbi multimediat, artin dhe dizajnin bashkëkohor, pranë Institutit Kërkimor Shkencor IKSH të Universitetit POLIS, mundësuar nga njësia e botimeve POLIS_press. Ndërkohë vetë “MAD magazine dhe “MAD center” janë produkte të energjisë së gjeneruar nga stafi, studentët dhe rrjeti i kolegëve e partnerëve brenda dhe jashtë vendit të “Shkollës së Artit dhe Dizajnit të Aplikuar” pranë U_POLIS. “MAD magazine” është një botim special dhe i profilizuar në kuadër të periodikut shkencor “Forum A+P” mbi arkitekturën dhe planifikimin urban njohur me vendim zyrtar të KVTA/MASH, Vendim Nr. 153, Dt. 08.10.2010.

6. Parathënie / Besnik Aliaj
10. Hyrje / Stefano Romano
12. Biografi / Sonia Jojic
15. Portrete / Portraits
27. Eksterier-Interier / External-Internal
49. Arkitekturë / Architecture
73. Venitje e Bukur / Beautiful Decay

M.A.D Magazine

Parathenie / Besnik Aliaj

Përse MAD Magazine?

Revista MAD Magazinë është një botim periodik i specializuar në fushën e multimedias, artit dhe dizajnit të aplikuar, si anex i periodikur shkencor Forum A+P, të Universitetit POLIS që operon në fushat e arkitekturës, planifikimit dhe mjedisit, njohur nga MASH- Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe KVTA- Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademike. MAD Magazine vjen si një përpjekje për të dokumentuar në mënyrë serioze përpjekjet e stafit dhe studentëve të degës Art- Dizajn i Aplikuar pranë U_POLIS, miqve e rrjetit të artistëve dhe dizajnerave në kuadër të nismës së MAD Center, Qendra e Ekspozim-Kërkimit të Multimedias, Artit dhe Dizajnit pranë POLIS-it.

MAD Magazine dhe MAD Center do të përpiqen të promovojnë dhe evidentojnë në Shqipëri artin alternativ dhe dizajnin e aplikuar në

funkcion të nevojave në rritje të shoqërisë dhe ekonomisë shqiptare në një kontekst më të gjerë rajonal dhe si pjesë e integritit me pjesën tjetër të Europës. Botimet do të fokusohen në punën e autorëve të veçantë, apo tikipeve, projekteve dhe eventeve specifike që do të organizohen nga këta aktorë, si një referencë e rëndësishme praktike dhe teorike në këto fusha në Shqipëri. Përmes këtij dokumentimi do të kontribuohet për të krijuar një literaturë referuese duke investuar sidomos në CV profesionale të artistëve dhe dizajnerave të rinj që ofrojnë ide alternative premtuese.

Në këtë kuadër MAD Magazine do të jetë një seri katalogësh profesionalë me të gjitha kreditet e botimeve serioze , përfshi: ISSN dhe standard ISO, ekip botimi dhe board shkencor-profesional, konsu-

lence dhe dizajn të specializuar, koment dhe editorial, etj. Ajo do të bëhet zëdhënëse e një gjeneratë të re artistësh dhe dizajnerash që shpresojmë se do të kultivojnë një frymë të re arti dhe estetike që i shërben jo vetëm shijes dhe egos intelektuale, por ka vlera praktike për sipërmarrjen dhe prodhimin vendas në rritje. Mbi të gjitha kërkohet të impaktohet shija e publikut të gjerë, e cila në kushtet e një tranzicioni të vështirë dhe politikave radikale neo-liberale ka lënë vend për konfuzion, pseudo-kulturë dhe turbo-kapitalizëm.

Në këtë numër të parë kemi privilegjin të nisim rrugëtimin e MAD Magazine duke prezantuar jo rastësisht një artiste- dizajnerë të re dhe të talentuar Sonja Jojic, e cila hap siparin e revistës me një përmbledhje të punëve të saj me ekspozitën fotografike që ka debutuar pranë U_POLIS.

Sonja Jojic ka studiuar në fëmijëri dhe rininë e hershme në Tiranë dhe më vonë u zhvendos në Detroit, USA, ku studioi për art- dizajn. Më pas u rikthye në Tiranë ku punon dhe specilizohet më tej në këtë fushë. Ekspozita e saj dhe numri i parë i revistës janë një mesazh i mirë shprese që kjo nismë do të ecë në udhë të mbarë.

Suksese MAD Magazine.



STILL EKSPOZITA

Hyrje / Stefano Romano per Ekspoziten “Still”

Në gjuhën e fotografisë, Still (Ende) është përfaqësimi në një imazh, të një serie objektesh të pajeta. Kompozimi i imazhit, i cili sipas kuptimit të parë të fjalës duhet të na transmetojë një imazh pa jetë, ne fakt në të kundërtën, përmban një forcë të madhe evokative/ shprehëse. Ne, si njerëz, e rrethojmë veten me objekte, ndërtojmë shtëpi, krijojmë rrethe, qytete, metropole me qëllimin që të krijojmë strehim; por vetë nga natyra jonë, gjatë jetesës në këto vende i mbushim ato me ndjenjat e jetës tonë; në këtë mënyrë, çdo qoshe e qytetit merr një vlerë jetike. Në serinë e fotografive të Sonia Jojic, kombinimi i këtyre dy momenteve nuk është thjesht një ngjashmëri elementesh formale por shkon më thellë, në një konfrontim/ ballafaqim midis dy hapësirave. Nuk është thjesht arkitekturë e pastër, thjesht formë ose natyrë e qetë që shfaqet në këto foto, por jeta vetë në formën e momenteve që përmbajnë ndjenjat e njerëzve që i jetojnë ato çdo ditë.

Nga ana tjetër, Still në fotografi është momenti i kapjes së një imazhi në jetën e subjekteve të fotografuar. “Portretet” e Jojic qëndrojnë të izoluara nga konteksti, ku sfondi mungon – imazhe në të cilat vështrimi i spektatorit është “i detyruar” të përballë vështrimin e subjektit të fotografuar. Në këtë shkëmbim vështrimesh lind një dialog i vërtetë midis subjektit dhe spektatorit, jo i njëzëshëm, i cili nëpërmjet thellësisë të fotografisë së Soniës lejon spektatorin të përfshihet duke e transformuar këtë Still në një vazhdimësi, ku nuk përfundon, por është vazhdimisht i ushqyer nga shkëmbimi midis spektatorit dhe subjektit.

Prefiksi i përgjithshëm i fotografive të Sonia Jojic atëherë është Still (Ende), duke shprehur që ne ende e vëzhgojmë botën, ende japim kuptim dhe që ende jemi të gjallë.

SONIA JOJIC

Fotografe

Biografia

Sonia Jojic ka lindur në Tiranë, Shqipëri (1986). Jojic ushtron profesionin e Fotografes dhe Dizajnerit grafist midis USA dhe Shqipërisë. Pas diplomimit të shkollës së mesme në 2004, u zhvendos në Detroit, Michigan ku kreu studimet në Wayne State University, në Media Art dhe Komunikim - Imazhe Digitale dhe Fotografi, gjithashtu u specializua në Fotografi te Arteve të Bukura.

Aktualisht punon në Departamentin e Art-Dizajnit në Universitetin POLIS në fushat Multimedia, Fotografi, Fashion Design dhe Qeramikë.

Që në moshë të re nisi punën me skicime të shumta, por interesi për fotografinë nisi kur iu dhurua nga i jati një aparat fotografik. Ajo e gjeti veten të magjepsur pas porteteve të njerëzve ku motra e saj i

shërbeu si modeli i parë. Gjatë viteve të kolegjit dhe më pas ka punuar si fotografe e pavarur mes Tiranës dhe Detroit duke bashkëpunuar me agjensi modelesh dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si: *Remapping Detroit*, mundësuar nga bashkia e Detroit; *Bing*; *Wayne Mania* dhe *Art Mania* ekspozita në Detroit, si dhe ekspozita me punimet e saj "ENDE" në U_POLIS, Tiranë. Fokusi kryesor i punëve janë portretet, natyrë e qetë, dhe arkitekturë. Jojic njihet për formatin e madh të porteteve njerëzore.

Kategoritë e punimeve të saj në këtë numër janë të ndara në POR-TRETE, INTERIER-EKSTERIER, ARKITEKTURË, dhe VENITJE E BUKUR.

Filozofia e saj për këtë medium është "Fotografia kap momente nga koha jonë duke e mbajtur ende atë".

Portrete
Portraits













Eksterier / Interier
External / Internal























ARKITEKTURË
ARCHITECTURE


























VENITJE E BUKUR

BEAUTIFUL DECAY
























MiA.D

magazine

1 multimedia·art.design

Kontakt:

Rr. "Bylis " Nr. 12, Autostrada Tirane – Durres, Km.5, Kashar. Kodi Postar 1051,
KP 2995, Tirana Albania

Tel: +355.(0)4.24074 – 20/21, Fax: +355.(0)4.2407422,

Cel: +355.(0)69.20 – 34126 / 81881,

E-mail: forum_ap@universitetipolis.edu.al Web: www.universitetipolis.edu.al